BORDO MICRO

PRODUKT PËR MBROJTJEN E BIMËVE



GHS09

"Lexo fleteudhezuesin para perdorimit"

BORDO MICRO eshte fungicid-baktericid me veprim parambrojtes-kontakti, ne formen e mikrogranulave te dispergueshme ne uje. Perdoret ne trajtimet dimerore ne peme frutore, vreshta, ullinj si dhe per kontrollin e paraziteve kerpudhore ne kultura te ndryshme bujqesore gjate vegjetacionit.

Lënda vepruese: 20 *% (200g/kg) bakër metalik në formën e përzierjes bordoleze.*
Formulimi: *Granula të dispergueshme në ujë (WG).*

Masat parambrojtëse:

- H410 Shumë toksik për gjallesat ujore me efekte afatgjata.
- Mbajeni në vende të sigurta dhe të pa arritëshme nga fëmijët.
- Ruajeni në vende të thata dhe të freskëta, larg ushqimeve dhe pijeve për njerëzit si dhe ushqimeve për blegtorinë.
- Evitoni kontaktet e zgjatura të syve dhe lëkurës me preparatin.
- Evitoni marrjen e preparatit me organet e frymëmarrjes gjatë përgatitjes së solucionit spërkatës dhe gjatë spërkatjes.
- Gjatë përdorimit të tij mos hani, mos pini ujë dhe duhan.
- P273: Shmangni derdhjet në mjedis.
- P280: Vishni doreza mbrojtëse/ veshje mbrojtëse/ pajisje mbrojtëse për fytyrën/ pajisje mbrojtëse për sytë.
- P391: Mblidhni pastroni rrjedhjet.
- Në përfundim të punës lani paisjet mbrojtëse, mjetet spërkatëse.
- Pas përfundimit të punës lani duart dhe pjesët e ekspozuara të trupit.
- P501: Shkatërroni ose largoni përmbajtjen/ambalazhin në përputhje me rregullat në fuqi.
- EUH401: Për të shmangur rreziqet ndaj njerëzve dhe mjedisit vepro në përputhje me instruksionin e përdorimit.

Udhëzime për ndihmën e parë dhe këshilla për mjekun:

- Në rast kontakti me sytë: Në rast kontakti, shpëlajini menjëherë sytë me shumë ujë për të paktën 15 minuta. Mos harroni të hiqni lentet e kontaktit. Kërkoni menjëherë ndihmë mjekësore.
- Në rast kontakti me lëkurën Në rast kontakti, shpëlajeni menjëherë lëkurën me shumë ujë. Kërkoni ndihmë mjekësore nëse zhvillohet irritim.
- Në rast thithje të tretësirës spërkatëse me organet e frymëmarrjes: i aksidentuari dërgohet në një mjedis me ajër të pastër. Kërkoni kujdes mjekësor.
- Në rast gëlltitjeje: Kërkoni menjëherë ndihmë mjekësore dhe tregojini personelit mjekësor këtë fletë ose etiketën e produktit; Kontrolloni frymëmarrjen; Nëse është e nevojshme, aplikoni frymëmarrje artificiale;Mbajeni pacientin në qetësi; Ruani temperaturën normale të trupit; Asnjëherë mos i jepni asgjë nga goja një personi pa ndjenja; Nëse është gëlltitur produkti, mos provokoni të vjella.
- Nëse personi është pa ndjenja, vendoseni në pozicion anësor, me kokën më poshtë se pjesa tjetër e trupit dhe me gjunjët gjysmë të përkulur.
- P310: Kërkoni menjëherë ndihmë tek një doktor ose në një qendër antihelmimi.
- Shënime të përgjithshme: Nëse simptomat vazhdojnë, kontaktoni një mjek.

TERAPIA: Të behet lavazh stomaku me qumësht dhe të bardhë veze, në rastet kur niveli i bakrit është i lartë përdorni lënde xhel-formuese, si penicilamina ne rruge orale ose CaEDTA dhe BAL intramuskular.

Përdorimi:

Ne vreshta, per trajtimet preventive dimerore, me 1-1.2%.
Per trajtimet ne vegjetacion per kontrollin e *vrugut*: me 0.5%, ne infeksione te larta deri 0.8%.
Ne pemet frutore: Per trajtimet dimerore si mase preventive ne kontrollin e semundjeve te ndryshme bakteriale si *zjarri bakterial* etj., *kromave, flete perdredheses, flete birueses* etj., me 1.5% dhe ne vegjetacion me 1%.
Agrume: Per kontrollin e *Malsekos, Tymthit, Bakteriozes* etj, me 0.5-1%.
Ullinj: Per kontrollin e *Syrit te palloit, dhe Tymthit,* me 0.5-1%.
Domate: Per kontrollin e *Vrugut, Bakteriozave, Alternaries, Septoriozes*, me 0.7-1%.
Perime te ndryshme: Per kontrollin e *Vrugut, Septoriozes, Ndryshqeve, Bakteriozave, Altertnaries,* me 0.7%.
Për trajtimin e plagëve, me 10 %, duke e aplikuar atë me një furçë ose një thikë palete.

Vërejtje për përdorimin:

Nuk lejohet te perzihet me produktet e tjera.

Fitotoksiciteti:
Mos trajtoni gjatë lulëzimit.
Ky produkt mund të jetë fitotoksik për kulturat që nuk janë përmendur në këtë etiketë. Në pjeshkë, kajsi dhe disa varietete molle (Abbondanza, Belfort, Black Stayman, Golden Delicious, Gravenstein, Jonathan, Rome Beauty, Morgenduft, Stayman, Stayman Red, Stayman Ëinesap, Black Davis, King David, Renetta del Canada, Rosa Mantovana) dhe Dardhe (Abate Fetel, Buona Luigia d'Avranches, Butirra Clairgeau, Passacrassana, B.C. William, Dott. Jules Guyot, Favorita di Clapp, Kaiser, Butirra Giffard), të cilët janë të ndjeshëm ndaj bakrit, mund të jetë fitotoksike nëse përdoret gjatë zhvillimit të shpejtë vegjetativ. Në raste të tilla këshillohet mos-përdorimi.

Ndikimi në ekosistem:
Shumë helmues dhe me veprim të zgjatur për organizmat ujore. Mos shpërndani ambalazhet dhe mjetet e tjera në mjedis. Mos ndotni ujërat e rrjedhëshme, kanalet dhe basenet me tretesirën spërkatëse ose ambalazhet. Mos i pastroni pajisjet e aplikimit pranë ujërave sipërfaqësore/Shmangni ndotjen nëpërmjet kanaleve të kullimit nga oborret e fermave dhe rrugët. Menaxhoni rrjedhjet.

Karenca:
Sperkatja e fundit para vjeljes (kur perdoret si leng bordolez)**:** Domate dhe patëllxhan, 3 ditë për serrë, 10 ditë për kulturën ne fushë; Hudhër, qepë, kungullore, bizele, bishtaja, perime të freskëta, 3 ditë; Kultura të tjera, 15 ditë.

Magazinimi:
Ruhet ne ambalazhe origjinale dhe ne vende te thata e te ajrosura, ne temp 0 deri 35 ^{0}C.

Nr dhe data e regjistrimit: 140/1; date 6.2.2020.
Sasia neto e PMB-se, që ndodhet në ambalazhin baze: deri 25 kg.
Data e prodhimit..... ;
Data e skadencës ose periudha e ruajtjes (sipas kërkeseva të përcaktuara): 3 vjet;
Numri i partise se mallit (serise) ose shenja te tjera identifikuese..... ;
Tipi i amballazhit baze: Material jo i pershkueshem nga uji (tre shtresore, ku shtresa e brendeshme eshte leter dhe e jashtmja plastike).
Emri dhe adresa e fabrikuesit te PMB-se: Industrias Químicas del Vallés (IQV) SA. **Adresa:** Mollet del Valles (Barcelona) Spanjë;
Emri dhe adresa e Aplikantit: Industrias Químicas del Vallés (IQV) SA. **Adresa:** Mollet del Valles (Barcelona) Spanjë;
Emri dhe adresa e ambalazhuesit (kur ambalazhimi kryhet ne Republiken e Shqiperise): .....